- Deklaratën e pajtimit me shkrim nga të dy prindërit, e vërtetuar te Noteri.
- Pajtimi i të miturit, më i vjetër se 14 deri në 18 vjet.
- Në rast se përkujdesjen e fëmijës së mitur e ka njëri prind, dëshmitë duhet të plotësohen vetëm nga njëri prind që e ka përkujdesjen e fëmijës së mitur. Në këtë rast kërkesës duhet t'i bashkëngjitet edhe dëshmia me të cilën vërtetohet se prindit në fjalë i është besuar përkujdesja ndaj fëmijës së mitur.
- Në rast se komisionet vendosin për lirimin e fëmijës së mitur nga shtetësia e Republikës së Kosovës, prindërit apo prindi i fëmijës së mitur është i obliguar të prezantojë dëshminë për pagesën e taksave administrative në shumë prej 50 euro.
- Të gjitha dokumentet e ofruara si dëshmi duhet të jenë të përkthyer në ndonjërin nga gjuhët zyrtare në Kosovë.
- Kjo procedurë vlenë edhe për fëmijët e adoptuar.

Procedurat e aplikimit për fitimin e shtetësisë së pjesëtarit të diasporës të Republikës së Kosovës

1. Kërkesa për fitimin e shtetësisë nga pjesëtari i diasporës parashtrahet personalisht për personin e moshës madhore apo përmes njërit prind për personat e mitur, në njërin nga shërbimet konsullore të Republikës së Kosovës apo në njërin nga Zyrat e Gjendjes Civile në Kosovë.

Kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni duhet bashkëngjitur këto dëshmi:

- Dëshminë që nuk është nën hetime penale dhe që nuk është i dënuar për vepra penale nga organi kompetent i shtetit të huaj, jo më të vjetër se 6 muaj.
 - Certifikata e vendbanimit në shtetin ku banon.
-
- Certifikatën e lindjes së Republikës së Kosovës nëse ka lindur në Kosovë, ose certifikatën e lindjes në shtetin ku ka lindur.
 - Certifikatën e martesës nëse është i martuar ose certifikatën e gjendjes martesore.
 - Certifikatën familjare.
 - Kopje e dokumentit të identifikimit të prindërve ose certifikata nga Gjendja Civile.
 - Kopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm me fotografi që duket qartë.
 - Dëshminë që nuk është nën hetime penale dhe që nuk është i dënuar për vepra penale, e lëshuar nga Gjykata kompetente e Republikës së Kosovës.

Dëshmitë e lidhjes së ngushtë ekonomike dhe familjare

Njëra nga kriteret në vijim konsiderohet si dëshmi e lidhjeve të ngushta ekonomike dhe familjare me Republikën e Kosovës:

- Referenca të personave që jetojnë në Kosovë dhe që janë në gjendje të dëshmojnë lidhjet e ngushta familjare (**NOTERI**).
- Dëshmi që posedojnë prona të paluajtshme në Republikën e Kosovës apo aktivitete ekonomike (**KADASTER – KOMUNË**).
- Lidhja e ngushtë ekonomike dhe familjare në Republikën e Kosovës nuk konsiderohet e përmbushur nëse personi nuk përmbush asnjërin nga kriteret nga paragrafi 1 i këtij neni.

PROCEDURA E APLIKIMIT PËR FITIMIN E SHTETËSISË SË KOSOVËS ME NATYRALIZIM I FËMIJËS SË MITUR TË PERSONIT TË NATYRALIZUAR

Fëmiu i mitur nën moshën 18 vjeçare i parashtruesit të kërkesës për natyralizim, e fiton shtetësinë e Republikës së Kosovës me natyralizim në bazë të natyralizimit të prindërve të tij. Parashtrimi i kërkesës për të miturin duhet t'i bashkëngjitet kërkesës për natyralizim të prindit dhe të parashtrohet nga prindi i tij apo nëpërmjet përfaqësuesit ligjor në Zyrën e Gjendjes Civile, në Komunën ku banon parashtruesi i kërkesës.

Kërkesës duhet bashkëngjitur këto dëshmi:

- Certifikata e lindjes së fëmiut.
- Dokumente zyrtare të vlefshme të prindërve, me të cilat dëshmohet identiteti i tyre.
- Pajtimi i fëmiut më të vjetër se 14 deri në 18 vjeç.
- Pajtimi me shkrim i prindërve i vërtetuar te Noteri.
- Taksa administrative në shume prej 50 euro.
- Kjo procedurë vlenë edhe për personat e mitur të adoptuar.

Dëshmitë dhe kriteret për regjistrimin e të dhënave personale në regjistrin qendror të gjendjes civile për personat mbi moshën 18 vjeçare dhe gjenerimin e numrit personal për herë të parë

- Kërkesa duhet të parashtrohet personalisht nga pala e interesuar.
- Kopjen e dokumentit të identifikimit, me afat.
- Dëshminë që ka banuar në Kosovë për një periudhë të pandërprerë prej së paku 5 vjetësh, para 1 janarit 1998, në territorin e Kosovës.
- Kopjen e kartotekës (Back up) së letërnjoftimit të ish RFJ-së, ose pasaportës së ish RFJ-së.
- Çdo dokument tjetër që vërteton shtetësinë e ish RFJ-së (librezë ustarake, shëndetësore, patentë shofer etj.).
- Dëshminë e adresës aktuale të vendbanimit në Republikën e Kosovës.

- Deklaratën e dy dëshmitarëve që dëshmojnë se kanë njohuri dhe e njohin nga afër personin për të cilën po deklarojnë.
- Fotografimi i personit sipas procedurës së caktuar nga ARC/MPB/ - Prishtinë.

Dëshmitë dhe kriteret për lëshimin e Dëshmisë së vdekjes për shqyrtimin e trashëgimisë

- Certifikata e vdekjes për trashëgimlënësin.
- Dokumenti i identifikimit për të vdekurin.
- Vërtetimi nga Arkivi ose kopja e librit të vdekjes për bashkëshorten e të vdekurit.
- Fotokopjet e dokumenteve të identifikimit të trashëgimtarëve të ligjshëm (letërnjoftimi ose pasaporta).
- Ekstraktet nga regjistri qendror i gjendjes civile për trashëgimtarët.
- Dëshmia origjinale e lëshuar nga zyra e Kadastrit për pasurinë e patundshme dhe pasurinë e tundshme për të vdekurin.
- Dëshmia për të holla (para) të gatshme, apo letra me vlerë në emër të të vdekurit.
- Deklarata nën betim nga noteri për trashëgimtarët e ligjshëm, të cilët pranojnë (deklarojnë) se janë trashëgimtar të mundshëm në pasurinë e të vdekurit.

Dëshmitë për lëshimin e vërtetimit mbi kujdesin financiar, ushqyeshmërinë e familjes

- Kërkesa parashtrohet në qendrën për shërbim të qytetarëve (QShQ).
- Ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile për personin i cili ndihmohet.
- Kopja e dokumentit të identifikimit për personin që ndihmohet.
- Kopja e dokumentit të identifikimit të parashtruesit të kërkesës.
- Dëshmia bankare për dërgimin e mjeteve financiare ose ndonjë dëshmi tjetër që dëshmon mënyren e dërgimit të mjeteve financiare, ose deklaratën për dërgimin kesh të mjeteve financiare.
- Fletëpagesa që dëshmon pagesën 20 euro, sipas nenit 7 të rregullores komunale nr. 09/2023 dhe të rregullores për ndryshim dhe plotësimin nr. 02/2024, për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Procedura e ankesave

Ankesat për këtë procedurë dërgohen te Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, i cili është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha ankesave të paraqitura nga palët, kundër vendimeve të organit komunal të gjendjes civile në Republikën e Kosovës. Baza Ligjore: Ligji Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile, Neni 7, pika 2, 3 dhe 4; Udhëzimi Administrativ MPB Nr. 05/2012 për Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave.

Formulari: Meqenëse formulari për ankesë nuk është përcaktuar me UA, Drejtoria e Administratës mund ta përdorë formën e përgjithshme për ankesa dhe ta përcjell tutje në ARC/MPB.

DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

REGJISTRIMI / BARTJET E PRONËS SË PALUAJTSHME PËR PERSONA FIZIKË DHE JURIDIKË

1. Aplikacioni i plotësuar nga parashtruesi i kërkesës
 2. Kopja e letërnjoftimit (personat fizikë) apo certifikata e biznesit (për persona juridikë / bizneset)
 3. Autorizimi për përfaqësim (dorëzim) të dokumenteve i noterizuar
 4. Kontratë valide e vërtetuar / noterizuar
 5. Aktvendimi dhe aktgjykimi i plotëfuqishëm
 6. Kontrata mbi privatizimin nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit - AKP
 7. Vendimet nga Agjencioni Kosovar i Pronës - KPA
 8. Vendimet administrative shtetërore
 9. Dëshmia e transferit bankar për të gjitha shitëblerjet, në vlerë mbi 10,000 Euro
 10. Vula e transakcionit nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa
 11. Deklaratë e transferit të paluajtshmërisë nga Njësi për Intelegjencë Financiare
 12. Fletëpagesa me taksa të aplikueshme
- Vërejtje: Në rast të mungesës së ndonjë nga dokumentet e lartpërmendura ju lutem këshillohuni me zyrtar të shërbimit për regjistrim të drejtave të pronës së paluajtshme – RDPP.

CERTIFIKATAT E PRONËSISË DHE KOPJET E PLANIT PËR PERSONA FIZIKË DHE JURIDIKË

1. Aplikacioni i plotësuar nga parashtruesi i kërkesës
 2. Kopja e letërnjoftimit (personat fizikë) apo kopja e certifikatës së biznesit (personat juridikë / bizneset)
 3. Autorizimi për përfaqësim (dorëzim) të dokumenteve i noterizuar
 4. Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë
 5. Fletëpagesa me taksa të aplikueshme
- Vërejtje: Në rast të mungesës së ndonjë nga dokumentet e lartpërmendura ju lutem këshillohuni me zyrtar në zyret pritëse ku edhe aplikoni për këto dokumente.

REGJISTRIMI I HIPOTEKËS PËR PERSONA FIZIKË DHE JURIDIKË

1. Aplikacioni i plotësuar nga parashtruesi i kërkesës
2. Kërkesa për regjistrim të hipotekës
3. Kontrata mbi hipotekën
4. Kontrata mbi kredinë
5. Procesverbal i vlerësimit të patundshmërisë
6. Kopja e letërnjoftimit (personat fizikë) apo certifikata e biznesit (personat juridikë / bizneset)
7. Autorizimi i zyrtarit të bankës
8. Letërnjoftimi i zyrtarit të autorizuar të bankës
9. Certifikata mbi të drejtën e pronës së paluajtshme dhe Kopja e planit
10. Fletëpagesa me taksat e aplikueshme.

Vërejtje: Në rast të mungesës së ndonjë nga dokumentet e lartpërmendura ju lutem këshillohuni me zyrtarin në zyrën e hipotekave.

Ç'REGJISTRIMI I HIPOTEKËS PËR PERSONA FIZIKË DHE JURIDIKË

1. Aplikacioni i plotësuar nga parashtruesi i kërkesës
2. Kërkesa për çregjistrim të hipotekës
3. Autorizimi i zyrtarit të bankës
4. Kopja e letërnjoftimit e personit të autorizuar të bankës
5. Fletëpagesa me taksat e aplikueshme.

Vërejtje: Në rast të mungesës së ndonjë nga dokumentet e lartpërmendura ju lutem këshillohuni me zyrtarin në zyrën e hipotekave.

NDARJE, BASHKIM, IDENTIFIKIM TË PARCELAVE, RI-RREGULLIM I KUFIJVE TË PARCELAVE, NDËRRIM KULTURE, MATJE E NDËRTESAVE DHE PJESËVE TË NDËRTESAVE, PËRCAKTIM I KUFIJVE TË PARCELAVE PËR PERSONA FIZIKË DHE JURIDIKË - NËSE APLIKOHET PËRMES GJEODETËVE TË DREJTORISË SË KADASTRIT

1. Aplikacioni i plotësuar nga parashtruesi i kërkesës
2. Kopja e letërnjoftimit (personat fizikë) apo certifikata e biznesit (për persona juridikë / biznese)
3. Pëlqimi për parcelizim apo bashkim nga Drejtoria e Urbanizmit për zonat urbane
4. Regjistri i fletëparaqitjeve
5. Certifikata mbi të drejtën e pronës së paluajtshme dhe kopja e planit
6. Fletëpagesa me taksat e aplikueshme për shërbim kadastral.

NDARJE, BASHKIM, IDENTIFIKIM TË PARCELAVE, RI-RREGULLIM I KUFIJVE TË PARCELAVE, NDËRRIM KULTURE, MATJE E NDËRTESAVE DHE PJESËVE TË NDËRTESAVE, PËRCAKTIM I KUFIJVE TË PARCELAVE PËR PERSONA FIZIKË DHE JURIDIKË - NËSE APLIKOHET PËRMES GJEODETËVE APO KOMPANIVE TË LICENCUARA

1. Aplikacioni i plotësuar nga parashtruesi i kërkesës
2. Kërkesa e palës të gjeodeti / kompania e licencuar
3. Kopja e letërnjoftimit e personave fizikë / pronarit të pronës së paluajtshme si dhe gjeodetit të licencuar
4. Pëlqimi për parcelizim / bashkim nga Drejtoria e urbanizmit për zonat urbane
5. Kopja e licencës së gjeodetit ose kompanisë së licencuar
6. Kopja e koordinatave të marrura zyrtarisht, së bashku me skicë
7. Regjistri i fletëparaqitjeve, manuali dhe CD-ja
8. Certifikata mbi të drejtën e pronës së paluajtshme dhe kopja e planit
9. Tabela e koordinatave të lexuara, matja e parë dhe e dytë (sipas kornizës në fuqi)
10. Fletëpagesa me taksat e aplikueshme për shërbim kadastral, koordinata gjeodezike.

Vërejtje: Në rast të mungesës së ndonjë nga dokumentet e lartpërmendura ju lutem këshillohuni me zyrtar të shërbimit për gjeodezi.

Procedura e ankesave

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, Ligjin Nr. 04/L-013 për Kadastër dhe akteve nënligjore, Zyrat Kadastrale Komunale janë kompetente për të shqyrtuar fillimisht ankesat lidhur me këtë procedurë administrative dhe pastaj nëse pala nuk është e kënaqur me përgjigjen e marrur, i drejtohet direkt Agjencisë Kadastrale të Kosovës – AKK-së. Si formular për paraqitje të ankesës mund të përdoret forma e përgjithshme për ankesa.

DREJTORIA PËR EKONOMI DHE INVESTIME KAPITALE

Qendra komunale për regjistrim të bizneseve

Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve (ARBK) është institucioni kryesor për regjistrimin dhe administrimin e bizneseve në Kosovë, duke vepruar nën Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. ARBK ofron një sistem elektronik modern që thjeshton procesin e regjistrimit për bizneset e reja dhe ekzistuese, duke mundësuar shërbime të shpejta, të qasshme dhe pa kosto për fillimin e aktivitetit ekonomik.

Regjistrimi i biznesit të ri

Një aplikim mund të bëhet në çdo qendër komunale të ARBK-së (Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës), varësisht nga selia apo vendi i ushtrimit të veprimtarisë së subjektit që kërkon regjistrimin. Lista e qendrave komunale është e publikuar në këtë faqe zyrtare të internetit të ARBK-së.

A. Çfarë duhet për regjistrimin fillestar?

I. Formulari i aplikimit

Për të filluar një regjistrim, një aplikanti i duhet të plotësojë formularin e aplikimit. Përpara se të plotësohet formulari i aplikimit, aplikanti duhet të dijë informacionin e mëposhtëm:

1. Formulari i aplikimit është specifik për lloje të ndryshme shoqërishtë tregtare që aplikojnë (persona fizikë që bëjnë biznes apo korporatë). Andaj, aplikanti duhet të sigurohet që ai/ajo e di, nëse aplikimi do të jetë për një person fizik, i cili do regjistrohet për të kryer biznes apo për një korporatë si dhe llojin e korporatës. Informacioni mbi kërkesat ligjore të shoqërive tregtare mund të gjendet në ligjin Nr.02//L-123 për Shoqëritë Tregtare. Ky ligj mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e internetit të ARBK-së.

2. Formularët e aplikimit mund të merren në dy mënyra;

a) Pranë çdo qendre të QRB-së; ose

b) Mund të shkarkohen nga kjo faqe zyrtare e internetit të ARBK-së;

3. Të gjitha instruksionet për plotësimin e tyre mund të gjenden në çdo qendër të QRB-së. Çdo zyrtar, pranimi është i gatshëm të ndihmojë aplikantin të plotësoi të gjitha rubrikat e detyrueshme të formularit të aplikimit.

II. Dorëzimi i aplikimit për regjistrim

1. Pasi formulari i aplikimit plotësohet, aplikanti (ose personi i autorizuar për regjistrim) paraqet formularin e aplikimit personalisht, në çdo qendër shërbimi të QRB-së, së bashku me dokumente të tjera shoqëruese, të duhura.

2. Aplikanti ose personi i autorizuar, identifikohet te zyrtari i QRB-së nëpërmjet një dokumenti origjinal identifikimi, si dhe (për personin e autorizuar) nëpërmjet një autorizimi të nënshkruar, për përfaqësimin e aplikantit për qëllim regjistrimi.

3. Zyrtari i pranimit verifikon që aplikimi dhe dokumentet shoqëruese janë të plota dhe të pranueshme nga QRB. Nëse aplikimi është i paplotë ose i pasaktë, zyrtari i pranimit do të njoftoi dhe ndihmoi për sqarimin dhe plotësimin e formularit.
4. Kur pranohet një formular aplikimi i plotësuar, duhet të jetë i nënshkruar nga aplikuesi apo përfaqësuesi i autorizuar.
5. Taksa, me rastin e regjistrimit të biznesit fillestar nuk paguhet, ndërsa për ndryshimet në biznesin ekzistues paguhet në bazë të Udhëzimit Administrativ të paraparë dhe të publikuar në faqen zyrtare të inernetit të ARBK-së.

Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Biznesit Individual (B.I.) apo Ortakëri e Përgjithshme (O.P.):

1. Plotësimi i formularit B
 2. Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë)
 3. Pëlqimin e agjentit të regjistruar në bazë të nenit 27.1 pika d) e Ligjit Nr. 02/L – 123
 4. Për ortakëri të përgjithshme marrëveshjen e ortakëve të përgjithshëm në bazë të nenit 29 të Ligjit Nr. 02/L – 123
- Afati për kryerjen e regjistrimit të biznesit individual dhe ortakërisë së përgjithshme në QRB (Qendra e Regjistrimit të Biznesit në Komunë) është 1 ditë.

Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Shoqërisë komandite (SH.K.M.):

1. Plotësimi i formularit Ao
2. Marrëveshja e shoqërisë në bazë të Nenit 31.1 të Ligjit Nr. 02/L – 123
3. Statuti
4. Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë) kopje të pronarëve, personave të autorizuar të përfshirë në biznes
5. Pëlqimin e agjentit të regjistruar në bazë të nenit 31.2 të Ligjit Nr. 02/L – 123.

Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.):

1. Plotësimi i formularit Ao
 2. Marrëveshja e shoqërisë në bazë të Nenit 86 të Ligjit Nr. 02/L – 123
 3. Statuti në bazë të nenit 33 të Ligjit Nr. 02/L – 123
 4. Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë) kopje të pronarëve, personave të autorizuar të përfshirë në biznes
 5. Pëlqimin e agjentit të regjistruar në bazë të nenit 33.2 të Ligjit Nr. 02/L – 123.
- Afati për kryerjen e regjistrimit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqërive aksionare në ARBK, është 3 ditë.

Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Shoqërive aksionare (SH.A):

1. Plotësimi i formularit Ao

2. Statuti në bazë të Nenit 35.1 të Ligjit Nr. 02/L – 123
3. Marrëveshjen apo Rregulloren e Shoqërisë sipas Nenit 138 të Ligjit Nr. 02/L – 123
4. Pëlqimin e agjentit të regjistruar në bazë të nenit 35.3 të Ligjit Nr. 02/L – 123
5. Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë) kopje të pronarëve, personave të autorizuar të përfshirë në biznes.

Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Kompanisë së huaj – Dega në Kosovë:

1. Plotësimi i formularit Ao
 2. Vendimi për hapjen e Kompanisë së huaj
 3. Vendimin për emërimin e Drejtorit (pasaporta kopje) dhe Agjentit të regjistruar (letërnjoftimi kopje)
 4. Vendimi nga gjykata e shtetit përkatës, që biznesi ekziston (i noteruar)
 5. Certifikata e biznesit (original apo kopje e noteruar, jo më e vjetër se tre muaj nga data e lëshimit dhe nëse nuk është në gjuhën shqipe, serbe apo angleze të përkthehet në njërin nga këto tri gjuhë dhe përkthimi të jetë i noteruar) që e hapë përfaqësinë në Kosovë
 6. Kopja e pasaportës së pronarit dhe drejtorit të Kompanisë së huaj
 7. Kopja e statutit të kompanisë së huaj
 8. Pëlqimin e Agjentit të Regjistruar në bazë të nenit 23 të Ligjit Nr. 02/L – 123.
- Vërejtje: Nëse pronari i biznesit nuk është prezent kur dorëzohen dokumentet atëherë aplikuesi mund t'i dorëzojë dokumentet me autorizim dhe letërnjoftim kopje.

Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Kooperativës Bujqësore:

1. Plotësimi i formularit Ko
2. Marrëveshja e Shoqërisë
3. Statuti
4. Vendimi për emërimin e drejtorit
5. Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë) kopje të anëtarëve, personave të autorizuar të përfshirë në biznes
6. Pëlqimin e agjentit të regjistruar në bazë të nenit 23 të Ligjit Nr. 02/L – 123.

Regjistrimi i ndryshimeve në biznes

Për të bërë ndryshime në biznesin tuaj ekzistues ju duhen këto dokumente si dhe t'i përdorni formularët përkatës, të mëposhtëm:

Për çdo ndryshim që dëshironi të bëni në biznesin tuaj individual, ju duhet ta përdorni formularin B.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të emrit të Biznesit Individual dhe Ortakërisë së përgjithshme:

1. Plotësimi i formularit B
2. Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve)
3. Të dorëzohet certifikata origjinale e biznesit.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të adresës së Biznesit Individual dhe Ortakërisë së përgjithshme:

1. Plotësimi i formularit B
2. Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve)
3. Të dorëzohet certifikata origjinale e biznesit.

Dokumentet që janë të nevojshme për Ndryshim të tipit të Biznesit Individual dhe Ortakërisë së përgjithshme:

1. Plotësimi i formularit B
2. Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve)
3. Të dorëzohet certifikata e biznesit, origjinale
4. Vërtetimi nga administrata tatimore për ndërrim të tipit të biznesit
5. Marrëveshja në mes të ortakëve (nëse është ortakëri e përgjithshme e noterizuar).

Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të numrit të punëtorëve në Biznes individual apo Ortakëri të përgjithshme:

1. Plotësimi i formularit B
2. Kopja e certifikatës së biznesit
3. Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve).

Dokumentet që janë të nevojshme për shtimin apo heqjen e veprimtarive në Biznes Individual apo Ortakëri të përgjithshme:

1. Plotësimi i formularit B
2. Kopja e certifikatës së biznesit
3. Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve).

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të pronarit në Ortakëri të përgjithshme:

1. Plotësimi i formularit B
2. Kopja e certifikatës së biznesit
3. Vërtetimi prej Administratës Tatimore të Kosovës, për ndërrim të pronarit
4. Kopja e letërnjoftimit të pronarit të kaluar dhe pronarit të ri
5. Marrëveshja në mes të pronarëve, e noterizuar.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të drejtorit apo agentit në Ortakëri të përgjithshme:

1. Plotësimi i formularit B
2. Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve)
3. Kopja e letërnjoftimit të drejtorit apo agentit
4. Vendimi për ndërrim të drejtorit, ndërsa për ndërrim të agentit duhet një deklaratë (e noterizuar)
5. Kopja e certifikatës së biznesit.

Dokumentet që janë të nevojshme për shtim apo heqje të njësisë në Biznesin Individual apo Ortakëri të përgjithshme:

1. Plotësimi i formularit B
 2. Kopja e certifikatës së biznesit
 3. Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve).
- Fletëpagesa duhet të merret në QRB në shumë prej 5 euro dhe të paguhet në bankë, në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.12/2022 për caktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të emrit të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Shoqërisë komandite ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit A1
 2. Aneks – Statutin
 3. Vendimin për ndryshim të statutit
 4. Vendim për ndryshim të emërimit
 5. Kopja e letërnjoftimit, aksionarëve
 6. Të dorëzohet certifikata origjinale e biznesit.
- Fletëpagesa duhet të merret në QRB në shumë prej 10 € dhe të paguhet në bankë, në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.12/2022 për caktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të adresës së Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Shoqërisë komandite ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit A3
2. Aneks – Statuti
3. Vendimi për ndryshim të statutit
4. Të ceket edhe në vendim edhe në aneks-statut, adresa e re
5. Të dorëzohet certifikata origjinale e biznesit
6. Kopja e letërnjoftimit të aksionarëve.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Tipit të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Shoqërisë komandite ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit A4
2. Aneks – Statuti
3. Vendimi për të ndërrim të statutit
4. Të dorëzohet certifikata e biznesit origjinale
5. Statuti i ri
6. Vërtetimi nga administrata tatimore për ndërrim të tipit të biznesit
7. Kopja e letërnjoftimit të aksionarëve.

Fletëpagesa duhet të merret në QRB në shumë prej 10 € të paguhet në bankë, në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.12/2022 për caktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të numrit të punëtorëve të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Shoqërisë komandite ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit A5
2. Aneks – Statuti
3. Kopja e Certifikatës së biznesit
4. Kopja e letërnjoftimit të aksionarëve

Fletëpagesa duhet të merret në QRB në shumë prej 10 € të paguhet në bankë, në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.12/2022 për caktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Kapitalit të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Shoqërisë komandite ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit A6
2. Aneks – Statuti
3. Vendimi për ndryshim të kapitalit, e noterizuar
4. Kopja e Certifikatës së biznesit
5. Kopja e letërnjoftimit të aksionarëve.

Fletëpagesa duhet të merret në QRB në shumë prej 10 € të paguhet në bankë, në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.12/2022 për caktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve.

Dokumentet që janë të nevojshme për shtim apo heqje të Veprimtarive të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Shoqërisë komandite ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit A7
2. Statuti
3. Vendimi për ndryshim të statutit
4. Kopja e Certifikatës së biznesit
5. Kopja e letërnjoftimit të aksionarëve.

Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 10 € të paguhet në bankë, në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.12/2022 për caktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga Agjensia për Regjistrimin e Bizneseve.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Pronarëve-Aksionarëve të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Shoqërisë komandite ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit A8
2. Statuti i noterizuar
3. Vendimi për ndryshim të statutit, e noterizuar
4. Kontrata mbi faljen ose shitjen e aksioneve e noterizuar
5. Kopja e Certifikatës së biznesit
6. Kopja e letërnjoftimit (pasaportat) të aksionarëve.

Fletëpagesa duhet të merret në QRB në shumë prej 10€ të paguhet në bankë, në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.12/2022 për caktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga Agjensia për Regjistrimin e Bizneseve.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Drejtorëve apo të Agjentit të Regjistruar të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Shoqërisë komandite ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit A9
2. Statuti i noterizuar
3. Vendimi për shkarkim dhe emërim të drejtorit /ëve apo të Agjentit të Regjistruar (deklaratën për Agjentin), e noterizuar
4. Kopja e Certifikatës së biznesit
5. Kopjet e letërnjoftimeve të drejtorit /ëve apo Agjentit të Regjistruar të shkarkuar dhe drejtorit /ëve të emëruar.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Njësive të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Shoqërisë komandite ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit A10
2. Statuti
3. Vendimi për ndryshim të statutit
4. Kopja e Certifikatës së biznesit
5. Kopja e letërnjoftimit të aksionarëve.

Fletëpagesa duhet të merret në QRB në shumë prej 10 € të paguhet në bankë, në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.12/2022 për caktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga Agjensia për Regjistrimin e Bizneseve.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Emrit të Kooperativës Bujqësore, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit K1
2. Statutin
3. Vendimin për ndryshim të statutit
4. Vendim për ndryshim të emërimit
5. Kopja e letërnjoftimit të anëtarëve
6. Të dorëzohet Certifikata origjinale e biznesit.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të adresës së Kooperativës Bujqësore, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit K3
2. Statuti
3. Vendimi për ndryshim të statutit
4. Të çeket edhe në vendim edhe në aneks-statut, adresa e re
5. Të dorëzohet certifikata origjinale e biznesit
6. Kopja e letërnjoftimit të anëtarëve.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Kapitalit të Kooperativës Bujqësore, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit K6
2. Statuti
3. Vendimi për ndryshim të kapitalit e noterizuar
4. Kopja e Certifikatës së biznesit

5. Kopja e letërnjoftimit të anëtarëve.

Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 10 € dhe të paguhet në bankë, në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.12/2022 për caktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Veprimtarive të Kooperativës Bujqësore, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit K7
2. Statuti
3. Vendimi për ndryshim të statutit
4. Kopja e Certifikatës së biznesit
5. Kopja e letërnjoftimit të anëtarëve.

Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 10 € dhe të paguhet në bankë, në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.12/2022 për caktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Pronarëve-Aksionarëve të Kooperativës Bujqësore, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit K8
2. Statuti i noterizuar
3. Vendimi për ndryshim të statutit i noterizuar
4. Kontrata mbi faljen ose shitjen e aksioneve, e noterizuar
5. Kopja e Certifikatës së biznesit,
6. Kopja e letërnjoftimit të anëtarit (anëtarëve) – aksionarit (aksionarëve).

Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 10 € dhe të paguhet në bankë, në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.12/2022 për caktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Drejtorëve të Kooperativës Bujqësore, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit K9
2. Statuti i noterizuar
3. Vendimi për shkarkim të drejtorit /ëve, i noterizuar
4. Vendimi për emërim të drejtorit /ëve të rinj, i noterizuar
5. Kopja e Certifikatës së biznesit
6. Kopjet e letërnjoftimeve të drejtorit /ëve të kaluar dhe drejtorit /ëve të ri.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Njësive të Kooperativës Bujqësore, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit K10
2. Statuti
3. Vendimi për ndërrim të statutit
4. Kopja e Certifikatës së biznesit
5. Kopja e letërnjoftimit të anëtarit (anëtarëve).

Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 10 € dhe të paguhet në bankë, në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.12/2022 për caktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve .

Kërkesa për shuarje të biznesit

Dokumentet që janë të nevojshme për shuarje të biznesit individual ose ortakërisë së përgjithshme:

1. Plotësimi i formularit D
2. Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve)
3. Certifikata Origjinale e biznesit
4. Vërtetimi prej Administratës Tatimore të Kosovës, për shuarjen e biznesit; afati kohor 10 ditë.

Dokumentet që janë të nevojshme për shuarjen e korporatave:

1. Plotësimi i formularit D
2. Shpallja në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë, në gjuhët zyrtare të Kosovës; një shpallje në madhësi jo më të vogël se 1/10 e faqes
3. Vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës për shuarje të biznesit
4. Vërtetimi nga Gjykata Ekonomike
5. Certifikata origjinale e biznesit
6. ID-të kopje të pronarit ose pasaportat kopje, nëse është pronari i huaj
7. Vendimin për Shpërbërjen vullnetare të Koorporatës:
 1. Vendimi për shuarje vullnetare
 2. Vendimi për likuidimin e korporatës
 3. Vendimi për emrimin e likuidator
4. Raporti mbi mjetet e kapitalit, të gjitha këto bëhen në bazë të ligjit 02 L-123 për shoqëritë tregtare, neni 229.

VËREJTJE: Nëse pronari i biznesit nuk është prezent kur dorëzohen dokumentet, atëherë aplikuesi mund t'i dorëzojë dokumentet me autorizim dhe letërnjoftimin kopje.

Dokumentet që janë të nevojshme për shuarjen e degës në Kosovë:

1. Plotësimi i formularit D
2. Shpallja në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë, në gjuhët zyrtare të Kosovës; një shpallje në madhësi jo më të vogël se 1/10 e faqes
3. Vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës për shuarje të biznesit
4. Vërtetimi nga Gjykata Ekonomike
5. Certifikata origjinale e biznesit
6. ID-të kopje të pronarit ose pasaportat kopje, nëse është pronari i huaj
7. Vendimin për Shpërbërjen vullnetare të Koorporatës
8. Vendimi për shuarje vullnetare
9. Vendimi për likuidimin e korporatës
10. Vendimi për emrimin e likuidator
11. Raporti mbi mjetet e kapitalit, të gjitha këto bëhen në bazë të ligjit 02 L-123 për shoqëritë tregtare, neni 229.

**LEJE PUNE
AUTO – TAXI**

Dokumentet që janë të nevojshme për marrjen e Lejës së punës për Auto – Taxi:

1. Certifikatën e biznesit të (MTI-së)
2. Vërtetimet mbi kryerjen e obligimeve ndaj Komunës (tatimi dhe mbeturina)
3. Patent shoferi (kopje), 5 vjet përvojë
4. Libreza e qarkullimit të automjetit (4 dyer dhe 4+1 ulëse)
5. Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit
6. Kopja e letërnjoftimit
7. Të mos ketë pengesa ligjore për ushtrimin e veprimtarisë “Taxi”
8. Të mos jet në mardhënjë pune
9. Pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria për Inspeksion
10. Certifikata e mjekut
11. Taxi – metri
12. Pagesa prej 30 euro, bazuar në Rregulloren për transportin rrugor në territorin e Komunës së Vushtrrisë, nr. 67/15.

Dokumentet që janë të nevojshme për vazhdimin e Lejes së Punës për Auto – Taxi:

1. Certifikatën e biznesit të (MTI-së)
2. Vërtetimet mbi kryerjen e obligimeve ndaj Komunës (tatimi dhe mbeturina)
3. Patentë shoferi (kopje), 5 vjet përvojë
4. Libreza e qarkullimit të automjetit (4 dyer dhe 4+1 ulëse)
5. Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit
6. Kopja e letërnjoftimit
7. Pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria për Inspeksion
8. Taxi – metri.

CERTIFIKATA PËR KONTRIBUTE

Dokumentet që janë të nevojshme për marrjen e Certifikatës për kontribute, për vitet e punës:

1. Dëshmia për periudhën deri në vitet 1988-1989
2. Letërnjoftimi kopje
3. Dëshmi nga Zyra e Arkivës në Drejtorinë për Kulturë.

Në bazë të këtyre dokumenteve dhe duke u bazuar në librat Amzë, për periudhën e pasluftës të Regjistrimit të Bizneseve lëshohet certifikata për kontribute e cila vazhdon për procedurë në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Sektori i bujqësisë

Pëlqimi për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore (përkohësisht dhe përhershëm)

1. Lista poseduese e tokës
2. Formulari i plotësuar
3. Kopja e planit
4. Vërtetimi mbi pagesën e tatimit në pronë
5. Letërnjoftimi kopje.

Lëshimi i vërtetimit që pala merret me bujqësi

1. Kopja e letërnjoftimit
2. Vërtetimi i tatimit në pronë
3. Lista poseduese e tokës
4. Nëse pala merret me blegtori, një vërtetim nga veterineri mbi numrin e krerëve që posedon
5. Formulari i plotësuar.

Sektori për pylltari

Lëshimi i fletëpërcjelljes për transportin e masës drunore

1. Aplikacioni
3. Fleta poseduese (origjinali)
4. Kopja e planit (origjinali)
5. Nëse kërkesën e bënë anëtar i familjes së pronarit të pyllit, bashkangjitet ndonjë dokument që dëshmon afërsinë familjare (certifikata mbi bashkësinë familjare, certifikata e lindjes, etj).

Lëshimi i fletëpërcjelljes për ri-transport të masës drunore

1. Fletëpërcjellja origjinal
2. Fletëpagesa
3. Aplikacioni i plotësuar.

DREJTORIA PËR INSPEKTIME

Pranimi teknik i lokaleve afariste

1. Kërkesa për pranim teknik
2. Kopja e letërnjoftimit
3. Certifikata për regjistrimin e biznesit (komplet)
4. Nëse lokali është me qira edhe kontrata e qirasë.

Konstatimin e mallit të prishur – joushqimor

1. Kërkesa për konstatimin e mallit të prishur – joushqimor
2. Kopja e letërnjoftimit
3. Certifikata për regjistrimin e biznesit (komplet)
4. Nëse lokali është me qira edhe kontrata e qirasë.

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Pëlqim në lokacion për ngritje të objektit dhe pëlqimi i dokumentacionit investivo - teknik për masat e sigurisë për mbrojtje nga zjarri

1. Fleta poseduese ose kontrata, vendimi
2. Kopja e planit
3. Projekti kryesor
4. Projekti – elaborati i mbrojtjes nga zjarri
5. Kopja e letërnjoftimit
6. Për persona juridikë edhe certifikata e biznesit.

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROTJE TË MJEDISIT

KUSHTET PËR NDËRTIM TË RI DHE NDËRTIM TË PËRKOHSHËM - KATEGORIA I

Me Ndërtim të Ri, nënkuptojmë ndërtimin që kryhet në pjesë të një parcele toke ku nuk ka ndërtim ose që zëvendëson plotësisht ndërtimin ekzistues (Neni 3- Ligji Nr. 04/L – 110 për Ndërtim). Kushtet ndërtimore janë kushtet të cilat shërbejnë si bazë për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për çdo parcelë kadastrale, përmes zonimit dhe klasifikimit të shfrytëzimit të tokës, siç përcaktohen në Hartën Zonale të Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Veçanta, Hartën Zonale të Komunës dhe Planet Rregulluese të Hollësishme (Neni 21- Ligji Nr. 04/L-174 i Planifikimit Hapësinor). Nëse nuk ekziston plani rregullativ urban, aplikuesi i propozon organit kompetent kushtet ndërtimore që dalin mbi bazën e diametrit prej pesëdhjetë (50) metrave nga vijat kufizuese të parcelës tokësore për të cilën aplikuesi ka kërkuar të ndërtoj objektin e tij ndërtimor (Neni 18 I Ligjit Nr. 04/L – 110, për Ndërtim).

APLIKIMI DHE DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM:

1. Kopja e planit dhe Certifikata në emër të pronarit të parcelës (dëshmia mbi pronën, jo më e vjetër se 6 muaj, në formatin origjinal ose të fotokopjuar dhe të vërtetuar nga noteri. Kopjet e planit të parcelave kadastrale duhet të jenë të harmonizuara me vektorët kadastral)
2. Fotokopja e dokumentit të identifikimit të pronarit/pronarëve të parcelës dhe investitorit (apo certifikata e biznesit)
3. Shtojca 1 për Kushte Ndërtimore, për kategorinë e parë (1)
4. Incizimi gjeodezik i parcelës (në sistem shtetëror Kosova Ref. 01) dhe sipërfaqes në diametër prej 50m, prej kufirit të parcelës
4. Pëlqimi i noterizuar nga pronarët e parcelave fqinje për sigurimin e qasjes deri në rrugë publike (vetëm për parcelat që nuk kanë qasje në rrugë, marrëveshje e noterizuar me fqinjët nëpër pronën e të cilëve kalon rruga)
5. Projekt – propozimi ideor i shtëpisë apo kompleksit të shtëpive individuale me zgjidhje urbane, sipas Udhëzimit Administrativ Nr.06/2017 (nga kompania për projektim)
- Për objektet e përkohshme: projekti ideor, zgjidhja urbane në bazë të kriterëve të Rregullores Komunale, Rregullores për Rregullat dhe Procedurat e Ndërtimit të Objekteve në Territorin e Komunës së Vushtrrisë, Nr.205/13, të datës 10.09.2013
6. Informata nga plani (PZHK, HZK ose PrrU – opsionale)
7. Pëlqimi nga fqiu kur ndërtesa vendoset në kufi të parcelës apo edhe në distancë më të vogël se sa që parashihet me planin (marrëveshje e noterizuar)
8. Orto foto të lokacionit (duke përfshirë parcelën dhe ndërtesat përreth, deri në diametër prej 50m)

KUSHTET PËR RINDËRTIM TË NDËRTESAVE - KATEGORIA I

Kushtet ndërtimore janë kushtet të cilat shërbejnë si bazë për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për çdo parcelë kadastrale, përmes zonimit dhe klasifikimit të shfrytëzimit të tokës, siç përcaktohen në Hartën Zonale të Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Veçanta, Hartën Zonale të Komunës dhe Planet Rregulluese të Hollësishme (Neni 21- Ligji Nr. 04/L-174 i Planifikimit Hapësinor).

Nëse nuk ekziston plani rregullativ urban, aplikuesi i propozon organit kompetent kushtet ndërtimore që dalin mbi bazën e diametrit prej pesëdhjetë (50) metrave nga vijat kufizuese të parcelës tokësore, për të cilën aplikuesi ka kërkuar të ndërtoj objektin e tij ndërtimor (Neni 18 i Ligjit Nr. 04/L – 110 për Ndërtim).

Me Rindërtim nënkuptojmë punën ndërtimore që ka për synim ndryshimin substancial të një ndërtimi, përshebull:

- ☐ Ndërtim i katit të ri të një ndërtese ose largim i një kati ekzistues, si dhe ndryshim i gabaritit të ndonjërit kat për më shumë se një (1) metër;
- ☐ Ndryshim i madhësisë së elementeve arkitekturore të pjesës së jashtme për më shumë se dy përqind (2 %) dhe zero presje një (0,1) metër;
- ☐ Zëvendësim, largim, ose riparim i pjesëve strukturore të ndërtimeve;
- ☐ Ndryshim i projektit ekzistues sipas të cilit paraprakisht është lëshuar certifikata e shfrytëzimit;
- ☐ Modifikim, zgjerim ose reduktim i sistemeve të shërbimeve publike për përdorim të përbashkët në ndërtim.

APLIKIMI, KOMPLETIMI DHE DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM:

1. Kopja e planit dhe Certifikata në emër të pronarit të parcelës (dëshmia mbi pronën, jo më e vjetër se 6 muaj, në formatin origjinal ose të fotokopjuar dhe të vërtetuar nga noteri. Kopjet e planit të parcelave kadastrale duhet të jenë të harmonizuara me vektorët kadastral)
2. Fotokopja e dokumentit të identifikimit të pronarit/pronarëve të parcelës/parcelave dhe investitorit
3. Incizmimi gjeodezik i parcelës (në sistem shtetëror Kosova Ref. 01) dhe sipërfaqes në diametër prej 50m, prej kufirit të parcelës
(Të përgaditet nga kompania e licensuar gjeodezike dhe dorëzimi të bëhet në formatin digjital edhe në kopje të fortë)
4. Pëlqimi i noterizuar nga pronarët e parcelave fqinje për sigurimin e qasjes deri në rrugë publike (vetëm për parcelat që nuk kanë qasje në rrugë, marrëveshje e noterizuar me fqinjët nëpër pronën e të cilëve kalon rruga)
5. Projekti i gjendjes ekzistuese dhe propozimi për rindërtim, me përshkrimin teknik për punët që kërkohet të zhvillohen me rindërtim
(Nga kompania për projektim)
6. Analiza e stabilitetit të ndërtesës ekzistuese dhe ndikimi i rindërtimit në atë ndërtesë (nga eksperti i lëmisë apo kompania e licencuar)
7. Informata nga plani (PZHK ose PRRU – opcionale)
8. Pëlqimi nga fqiu, kur pjesa e ndërtesës për të cilën kërkohet rindërtimi ofrohet në distancë më të vogël se të paraparë me kriteret e planit, ose rindërtohet në kufi të parcelës me fqin (marrëveshje e noterizuar)

9. Fotografi të lokacionit (duke përfshirë parcelën dhe ndërtesat përreth deri në diametër prej 50m)
10. Leja e ndërtimit apo leja e legalizimit të ndërtesës ekzistuese (me dokumentacionin teknik).
(Në rast se ndërtesa është në procedurë të legalizimit, vërtetimi që ndërtesa figuron në regjistrin e Ndërtimeve pa leje).

KUSHTET PËR NDËRTIM – KATEGORIA II

Kushtet ndërtimore, janë kushtet të cilat shërbejnë si bazë për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për çdo parcelë kadastrale, përmes zonimit dhe klasifikimit të shfrytëzimit të tokës, siç përcaktohen në Hartën Zonale të Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Veçanta, Hartën Zonale të Komunës dhe Planet Rregulluese të Hollësishme (Neni 21- Ligji Nr. 04/L-174 i Planifikimit Hapësinor). Nëse nuk ekziston plani rregullativ urban, aplikuesi i propozon organit kompetent kushtet ndërtimore që dalin mbi bazën e diametrit prej pesëdhjetë (50) metrave nga vijat kufizuese të parcelës tokësore për të cilën aplikuesi ka kërkuar të ndërtoj objektin e tij ndërtimor (Neni 18 I Ligjit Nr. 04/L – 110 për Ndërtim).

APLIKIMI, KOMPLETIMI DHE DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM:

1. Kopja e planit dhe Certifikata e pronësisë në emër të pronarit/pronarëve të parcelës/ parcelave kadastrale (dëshmia mbi pronën, jo më e vjetër se 6 muaj, në formatin origjinal ose të fotokopjuar dhe të vërtetuar nga noteri. Kopjet e planit të parcelave kadastrale duhet të jenë të harmonizuara me vektorët kadastral)
2. Fotokopja e dokumentit të identifikimit të pronarit/pronarëve të parcelës/ parcelave dhe investitorit
3. Marrëveshja për bashkë-investim në mes të pronarëve të parcelave dhe investitorit (e noterizuar)
4. Shtojca Nr.1
5. Pëlqimi i noterizuar nga pronarët e parcelave fqinje për sigurimin e qasjes deri në rrugë publike (vetëm për parcelat që nuk kanë qasje në rrugë, marrëveshje e noterizuar me fqinjët nëpër pronën e të cilëve kalon rruga)
6. Për ndërtesat në pronësi publike, shtetërore, universitare, komunale, fetare etj., të sigurohet pëlqimi nga organi kompetent.
7. Informata mbi planin (PZHK – PRRU- opsionale)
8. Incizmimi gjeodezik i parcelës/parcelave, gjendjes ekzistuese (në sistem shtetëror Kosova Ref. 01) dhe sipërfaqes në diametër prej 50m, nga kufiri i parcelës
(Të përgaditet nga kompania e licensuar gjeodezike dhe dorëzimi të bëhet në formatin digjital edhe në kopje të fortë)
9. Projekt – propozimi i zgjidhjes urbane dhe projektit ideor të ndërtimit (në kopje të fortë dhe në formatin digjital, duke përfshirë dhe prezentimin e zgjidhjes nga kompania projektuese)
10. Fotografi të lokacionit (duke përfshirë parcelën dhe ndërtesat përreth, deri në diametër prej 50m)

LEJA NDËRTIMORE, NDËRTIM I RI, RINDËRTIM DHE NDËRTIM TË PËRKOHSHËM- Kategoria I

Leje e lëshuar nga organi kompetent që shërben si bazë ligjore për realizimin e ndërtimit, në përputhje me këtë ligj.

APLIKIMI, KOMPLETIMI DHE DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM:

1. Kopja e planit dhe Certifikata e pronësisë të pronarit/pronarëve të parcelës/ave (dëshmia mbi pronën, jo më e vjetër se 6 muaj, në formatin origjinal ose të fotokopjuar dhe të vërtetuar nga noteri. Kopjet e planit të parcelave kadastrale duhet të jenë të harmonizuara me vektorët kadastral)
2. Fotokopja e dokumentit të identifikimit të pronarit/pronarëve të parcelës/ave dhe investitorit.
4. Informata mbi planin (nga planet rregulluese, PZHK- opsionale)
5. Kushtet ndërtimore të miratuara
6. Incizimi gjeodezik me ndërtesë të pozicionuar në sistemin koordinativ shtetëror, Kosova Ref. 01. (Nga kompania e licencuar gjeodezike)
7. Projekti kryesor me të gjitha fazat, në 3 kopje të forta dhe një kopje digjitale (konform dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për Kushte ndërtimore, Leje ndërtimore dhe Leje rrënimi për kategorinë I dhe të II-të të ndërtimeve me nr.06/2017, Rregullores Nr.03/2016 për Normat Minimale Teknike për Ndërtesat e banimit në Bashkëpronësi)
8. Pëlqimet nga kompanitë publike (KEDS, UJËSJELLËS, PTK, etj.)
9. Nëse ndërtesa pozicionohet në dy e më shumë parcela kadastrale, paraprakisht të bëhet bashkimi i tyre.
10. Te ndërtimet e përkohshme, deklarata e noterizuar e pronarit të parcelës, se është i pajtimit për afatin e përkohshëm të vendosjes –ndërtimit.

LEJE NDËRTIMORE – KATEGORIA II

Për të aplikuar për leje ndërtimore do të verifikohen:

1. Pagesa e taksave për leje ndërtimore paraprake, brenda kompleksit ndërtimor (nëse ka)
2. Nëse aplikuesi/investitori figuron në listën e borxhlinjëve
3. Bashkimi i parcelave kadastrale
4. Nëse parcela është në kontest gjyqësor
5. Nëse prona është në hipotekë.

KOMPLETIMI DHE DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM:
(Plotësimi i Aplikacionit përkatës)

1. Kopja e planit dhe Certifikata e pronësisë së pronarit/pronarëve të parcelës/ave (dëshmia mbi pronën, jo më e vjetër se 6 muaj, në formatin origjinal ose të fotokopjuar dhe të vërtetuar nga noteri. Kopjet e planit të parcelave kadastrale duhet të jenë të harmonizuara me vektorët kadastral)
2. Shtojca
3. Kërkesë për Leje ndërtimore për kategorinë II
4. Fotokopja e dokumentit të identifikimit të pronarit/bashkë-pronarëve të parcelës/ave dhe investitorit
5. Kushtet Ndërtimore dhe informata mbi planin, të lëshuara paraprakisht nga Drejtoria për Urbanizëm – ORIGINALE
6. Kontrata /marrëveshja e noterizuar e pronarëve me investitorin për bashkë-investim
7. Marrëveshja për zgjidhje urbane e vërtetuar te noteri (kur ky dokument nuk posedohet te kushtet ndërtimore)
8. Incizimi gjeodezik i ndërtesës/ndërtesave të pozicionuar/a në sistemin koordinativ shtetëror, Kosova Ref.01 (Nga kompania e licensuar gjeodezike)
9. Projekti kryesor me të gjitha fazat, në 3 kopje, në harmoni me rregulloret relevante në fuqi, për norma teknike
10. Pëlqimet nga kompanitë publike (KEDS, PTK, etj)
11. Lejen Mjedisore Komunale ose vërtetimin e aplikimit për këtë leje – kopje
12. Elaboratin dhe pëlqimin e mbrojtjes kundër zjarrit (ky dokument lëshohet nga Ministria e Punëve të Brendshme, AME)
13. Elaborati gjeomekanik (projekt nga kompania e licensuar, të dorëzohet në lidhje të fortë)
14. Elaborati Fizik i Ndërtimit dhe aplikimi I masave për Eficiencë të Energjise – (nga kompania e licensuar)
15. Pëlqimet e noterizuara nga fqinjët, në rast se parashihet të ndërtohet ndërtesa në kufi të parcelës
16. Nëse ndonjë parcelë kadastrale është në hipotekë (peng), paraprakisht të sigurohet pëlqimi nga pengmarrësi
17. Gabaritet e ndërtesës dhe tabela e kalkulimeve të sipërfaqeve përmbajtëse për kalkulim të taksave
18. Për ndërtesat në pronësi publike, shtetërore, universitare, komunale, fetare etj., të sigurohet pëlqimi nga organi kompetent
19. Në rastet e ndërtesave kolektive për banim/afarizëm dhe realizimit me faza, duhet të prezentohen dokumentacionet e lejeve dhe aktvendimet e taksave dhe tarifave të densitetit për Ndërtesat e realizuara në fazat e mëhershme.

VENDIM-PËLQIMI PËR NDËRTIMIN E MUREVE MBROJTËSE, RREGULLIMIN E OBORREVE, RRETHIMIN E PARCELAVE

KOMPLETIMI DHE DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM: (Plotësimi i Aplikacionit përkatës)

1. Kopja e planit dhe Certifikata e pronësisë të pronarit/pronarëve të parcelës (dëshmia mbi pronën, jo më e vjetër se 6 muaj, në formatin origjinal ose të fotokopjuar dhe të vërtetuar nga noteri. Kopjet e planit të parcelave kadastrale duhet të jenë të harmonizuara me vektorët kadastral)
2. Fotokopja e dokumentit të identifikimit, të pronarit
3. Projekt-propozimi i projektit ideor të zhvillimit të punimeve, duke përfshirë edhe gjendjen ekzistuese si dhe përshkrimi i zhvillimit të punimeve me materiale të përdorura
4. Përshkrimi i zhvillimit të punimeve me paramasë (nga profesionistë)
5. Fotografi të ndërtesës dhe lokacionit për ndërhyrje (duke përfshirë të gjitha ndërtesat në kuadër të parcelave)
6. Nëse kërkohet të ndërtohet në kufi të parcelës (sidomos te rrethoja e parcelës, apo muri mbrojtës), duhet të merret pëlqimi i noterizuar nga fqiu.
7. Incizimi gjeodezik i parcelës (në sistem shtetëror, Kosova Ref. 01) duke përfshirë edhe rrugën që ka qasje parcela
8. Leja e ndërtimit apo e legalizimit të ndërtesat ekzistuese (me dokumentacionin teknik, në rast se ndërtesa është në procedurë të legalizimit duhet vërtetimi që ndërtesa figuron në regjistrin e ndërtimeve pa leje).

LEJE PËR RRËNIM

KOMPLETIMI DHE DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM:

1. Kopja e Planit dhe Certifikata e Pronësisë (dëshmia mbi pronën, jo më e vjetër se 6 muaj, në formatin origjinal ose të fotokopjuar dhe të vërtetuar nga noteri. Kopjet e planit të parcelave kadastrale duhet të jenë të harmonizuara me vektorët kadastral)
2. Shtojca 10, Kërkesë për Leje Rrërimi
3. Kopja e letërnjoftimit të pronarit/pronarëve
4. Projekti i rrënit të ndërtesat me planin dinamik
5. Konstatim nga Drejtoria e Inspeksionit, nëse rrërimi i ndërtesave paraqet rrezik për banorët dhe rrethinën
6. Elaborati për të gjitha masat e sigurisë gjatë realizimit të rrënit
7. Plani i bartjes së mbetjeve inerte.

LËSHIMI I LEJES MJEDISORE KOMUNALE

1. Kërkesa
2. Certifikata e regjistrimit të biznesit
3. Fleta poseduese
4. Kopja e planit me koordinata
5. Kontratë për shfrytëzim të ngastrës
6. Raporti për leje mjedisore komunale, në tri kopje fizike dhe në një CD
7. Kopja e letërnjoftimit.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE
Lëshimi i vendimit për operatorët Taksi

1. Kërkesa
2. Vërtetimin e kryerjes së taksave komunale (në qoftë se e ka firmën e regjistruar)
3. Vërtetimin e kryerjes së tatimit në pronë
4. Librezën e automjeteve, së paku 5 automjete
5. Letërnjoftimin (fotokopje)
6. Patent shoferin për minimum 5 vozitës
7. Sigurimin e udhëtarëve
8. Aparatin e zjarrfikësve
9. Certifikatën e mjekut
10. Lejen e punës
11. Procesin mbi pranimin teknik të automjetit (të vitit kaluar)
12. Dëshminë mbi vendosjen e taksi-metrit
13. Certifikatën e regjistrimit të biznesit.

Lëshimi i pëlqimit për transport të veçantë të udhëtarëve

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit
2. Vërtetimin e kryerjes së taksave komunale (në qoftë se e ka firmën e regjistruar)
3. Vërtetimin e kryerjes së tatimit në pronë
4. Librezën e automjeteve
5. Letërnjoftimin (fotokopje)
6. Patent shoferin
7. Sigurimin e udhëtarëve
8. Aparatin e zjarrfikësve
9. Certifikatën e mjekut
10. Lejen e punës, së paku 5 vjet përvojë pune
11. Procesin mbi pranimin teknik të automjetit (të vitit kaluar)
12. Autorizimi që është linjë e veçantë
13. Kërkesa.

Lëshimi i vendimit për ndërhyrje në infrastrukturën publike të qytetit (prerjen e asfaltit) më qëllim të rregullimit të rrjetit të ujësjellësit, kanalizim, elektrikë

1. Lejen e ndërtimit të shtëpisë apo objektit
3. Letërnjoftimin (fotokopje)
4. Projektin vetëm për rastet kur ushtrohet kërkesa për kyqjen e objektit/pompës së benzinës në rrugë publike)
5. Vërtetimin e tatimit në pronë
6. Kërkesa.

Lëshimi i aktvendimit për shfrytëzimin e ndonjë lokacioni publik, për parkim të rezervuar, ndalje (ngarkim-shkarkim) të mallrave në trotuar, për hyrje me kamion

1. Kërkesa
2. Vërtetimin e kryerjes së taksave komunale (në qoftë se e ka firmën e regjistruar më herët)
3. Librezën-at e automjetit-ëve (fotokopje) që parkohen në parkingun e rezervuar
4. Letërnjoftimin (fotokopje)
5. Vërtetimin e kryerjes së tatimit në pronë
6. Certifikatën e regjistrimit të biznesit.

Lëshimi i aktvendimit për parkim të rezervuar

1. Librezën e automjetit (fotokopje) që dëshiron ta parkojë në parkingun e rezervuar
2. Letërnjoftimin (fotokopje)
3. Leja e biznesit
3. Vërtetimin e kryerjes së tatimit në pronë
4. Kërkesa.

Lëshimi i lejes për zhvarrosjen e mbetjeve të kufomave

1. Kërkesa
2. Licencën/Lejen e punës për kryerjen e shërbimeve të ekshumacionit (zhvarrosjen) të kufomës
3. Autorizimin për kompaninë nga familjarët për ekshumacionin (zhvarrosjen) e mbetjeve të kufomës
4. Certifikatën e vdekjes së kufomës edhe nga administrata e jonë (të re)
5. Vendimin për ekshumacionin nga Ministria e Shëndetësisë/Inspektoriati Sanitar i Kosovës
6. Letërnjoftimin e pronarit (përfaqësuesit) të kompanisë (fotokopje)
7. Certifikatën e regjistrimit të kompanisë për ushtrimin e veprimtarisë së tillë.

Sektori për menaxhimin e mbeturinave:

1. Vërtetim për kryerjen e obligimeve
2. Kërkesë për kategorizim, kopja e pasaportës së shtetit, shtetas i të cilit është qytetari dhe gjendjen e faturës së rrymës.
3. Kërkesë për ndërrim pronari, kopja e kontratës së shitblerjes, kopja e letërnjoftimit
4. Kërkesë për pasivizim, gjendjen e rrymës
5. Kërkesë për lirim nga pagesa (rastet sociale)
6. Kërkesë për regjistrim, kopja e letërnjoftimit.

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

1. Vendim për ndarjen e subvencioneve (ndarjen e mjeteve financiare) për familjet të cilat paraqesin kërkesa me sëmundje të rënda, rasteve sociale, personave me aftësi të kufizuar si dhe me kushte të vështira ekonomike etj.
2. Vendime për pushim pa pagesë për punëtorët e QKMF-së dhe Shtëpisë së Komuniteteve
3. Vendime për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punëtorët e QKMF-së dhe Shtëpisë së Komuniteteve
4. Certifikata për shtesa për fëmijë për punëtorët në botën e jashtme
5. Vërtetim për familjet e dëshmorëve, invalidëve, viktimave të luftës, UÇK etj.
6. Njoftim lidhur me kërkesat e bëra për subvencionim me mjete financiare për familjet në nevojë
7. Njoftime të ndryshme sipas kërkesave të qytetarëve
8. Vërtetim për Praktikë, për Studentët e Mjekësisë dhe Infermieres.

Lista e shërbimeve që ofron Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF-ja)

Kujdesi parësor shëndetësor

1. Ekzaminimi mjekësor në: punkt, QMF ose QKMF, pa analiza laboratorike ose pa procedurë plotësuese diagnostiko me aparaturë.
2. Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF, me udhëzime të mjekut familjar
3. Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF, pa udhëzime të mjekut familjar
4. Ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente
5. Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatoren publike
6. Ultrazëri standard
7. Radiografi
8. EKG (të plotësohet me përjashtim të rasteve emergjente)
9. Analiza laboratorike - vetëm hemogrami dhe urina

10. Analizat laboratorike (komplet)
11. Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore
12. Audiograma
13. Shpëlarja e veshit
14. Dhënia e injeksionit intramuskular në shtëpi, përpos në raste emergjente
15. Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në raste emergjente
16. Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrim deri në shërim të plagës (vetëm në vizitën e parë)
17. Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor
18. Certifikatë shëndetësore për regjistrim në çerdhe ose kopshte fëmijësh, lirohen në institucione publike
19. Certifikatë shëndetësore për regjistrim në shkolla fillore, të mesme, të larta, fakultete dhe nivele të tjera të shkollimit, lirohen në institucione publike deri në moshën 26 vjeçare
20. Certifikatë shëndetësore për punësim
21. Certifikatë shëndetësore për sportist amator, lirohen në institucione publike
22. Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore
23. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive etj.
24. Certifikatë shëndetësore, janë valide për një periudhë 12 mujore.

Qendra për punë sociale

Kërkesë për vërtetim që ushtron të drejtën prindërore

1. Kërkesa
2. Letërnjoftimi i prindit
3. Certifikata e lindjes së të miturit
4. Vendimi i gjykatës
5. Vizita e menaxherit të rastit (në rast se nuk ka vendim gjykatë ose është fëmij jashtëmartesor)

Kërkesë që është caktuar kujdestari ligjor ndaj të miturit

1. Kërkesa
2. Letërnjoftimi i kujdestarit ligjor
3. Certifikata e lindjes/ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile
4. Certifikata e lindjes/ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile i të miturit
5. Vendim i qendrës për kujdestari.

Pëlqim për bartje të pasurisë

1. Kërkesa
2. Një dokument (kontratë)
4. Letërnjoftimi i kërkuesit.

Vërtetime të ndryshme:

1. Vërtetimi që është apo nuk është nën kujdestari

- 1.1. Kërkesë për vërtetim për punë, komisione të ndryshme, përcaktuar sipas legjislacionit;
- 1.2. Kërkesë për vërtetim për dëshmi të kujdestarisë për armëmbajtje me leje;
2. Vërtetimi që është apo nuk është në asistencë sociale;
 - 2.1. Kërkesa për vërtetim që është apo nuk është në asistencë sociale;
3. Vërtetimi që gjendet apo nuk gjendet në evidencën e personave të cilët kanë detyrime të pa përmbushura ligjore;
 - 3.1. Kërkesë për vërtetim, dëshmi të kujdestarisë për lirim nga shtetësia e R. Kosovës;
4. Pëlqimi për të drejtën në udhëtim jashtë vendit, në aktivitete për fëmijët pa kujdes prindëror;
 - 4.1. Fëmijët në nevojë për shërbime të OK, avokim për rregullimin e dokumentacionit;

5. Mendim për martesë të parakohshme mbi moshën 16 vjeçare;
 - 5.1. Mendim profesional për martesë të parakohshme, sipas legjislacionit në fuqi;
6. Pëlqimi për administrim rreth trashëgimisë për të mitur në kontest apo pa kujdes prindëror;
 - 6.1. Sipas nevojës, kërkesës së gjykatës për përfaqësim, mbrojtje të interesit të fëmijëve, parashikuar me Ligj;
7. Pëlqim për bashkim familjar;
 - 7.1. Kërkesa për konstatim të gjendjes jetësore për rastet e bashkimit familjar;
8. Propozim të masave mbikëqyrëse për të miturit me sjellje delikvente;
 - 8.1. Sipas detyrës zyrtare, propozim të masës së mbikëqyrjes nga Organi i Kujdestarisë dhe prindit;
9. Caktimi i Kujdestarit Ligjor;
 - 9.1. Sipas detyrës zyrtare, Kujdestari për fëmijët e shoqëruar pa kujdes prindëror;
10. Mbështetja me ndihmë materiale emergjente;
 - 10.1. Kërkesa për ndihmë materiale emergjente;
11. Vërtetimi për lirim të studentëve nga pagesat semestrale UP;
 - 11.1. Kërkesa me akt real administrativ nga UP, për lirim të studentëve në Asistencë Sociale;
12. Këshillime Sociale;
 - 12.1. Familjarë dhe sipas nevojës për individ të caktuar;
13. Formulari A1 për aplikim në asistencë sociale;
 - 13.1. Kërkesa për asistencë sociale;
14. Formulari për përkrahje materiale të familjeve me fëmijë me AK;
 - 14.1. Kërkesa me akt real administrativ nga QPS për aplikim material për fëmijët e familjeve më aftësi të kufizuara;
15. Vërtetim për prindërit vetëushqyes;
 - 15.1. Kërkesa për prind vetëushqyes për lirim nga kopshti, për mbështetje materiale/strehim etj.;
16. Autorizimi për tërheqjen e Asistencës Sociale;
 - 16.1. Kërkesa për tërheqjen e Asistencës Sociale në mungesë të bartësit të lëndës, parashikuar sipas Legjislacionit;
17. Aktvendime të ndryshme dhe shkresa të ndryshme (formimi i komisioneve etj.).

DREJTORIA PËR ARSIM

1. **Leje për praktikë në shkollë-** Studenti parashton kërkesën me shkrim në qendrën për shërbim të qytetarëve dhe Drejtoria e shqyrton në përputhshmeri me kërkesën, konform drejtimit që ka zgjedhur.

2. **Vendim për mbulimin e transportit brenda vendit-** Qytetari e parashton kërkesën me shkrim në qendrën për shërbim të qytetarëve dhe D.A pas shqyrtimit të kërkesës pranon ose refuzon kërkesën, gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës ekipi i D.A. (dy psikologë dhe drejtori i shkollës) e vërteton situatën faktike dhe jep mendim në bazë të të cilit vendos D.A, për rastet për personat me aftësi të kufizuara. Për rastet e tjera, vendos personi përgjegjës në bazë të vlerësimeve.

3. **Regjistrimi i fëmijëve në qerdhe publike.**

- Vërtetim për regjistrimin e vitit shkollor për arsimin dhe aftësimin profesional
- Certifikatë/diplomë për arsimin dhe aftësimin profesional
- Vërtetim për praktikë profesionale
- Certifikatë për provimet diferenciale për arsimin dhe aftësimin profesional
- Lëshimi i dokumenteve duplikat për shkollat e mesme.

DREJTORIA PËR BUXHET, THESAR DHE FINANCA

Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë

Nga Drejtoria për Buxhet, Thesar dhe Financa, gjegjësisht nga Sektori i Tatimit në Pronë, kërkesat rreth të gjitha çështjeve që ka të bëjë me regjistrimin, verifikimin dhe modifikimin e të dhënave për pronat e paregjistruara në territorin e komunës së Vushtrrisë, në QSHQ duhet të parashtrohet kërkesa/ankesa me shkrim duke i bashkangjitur:

1. Kopjen e letërnjoftimit
2. Kërkesën/ankesën me shkrim duke sqaruar arsyet e kërkesës
3. Kontratat e shitëblerjes së pronës
4. Faturën e Tatimit në pronë (përveç kërkesave për regjistrim prone).

Ndërsa, Certifikata/Vërtetimi i Pronës si dhe Fatura e Tatimit në Pronë, tërhiqen nga sportelet.

Pagesa e taksës rrugore për automjete motorike

Qëllimi kryesorë i kësaj procedure administrative është që përmes pagesës së taksës rrugore t'ua mundësoi palëve regjistrimin e automjeteve.

Pala, në zyret e tatimit në pronë, fillimisht e merr certifikatën e cila e vërteton që ka paguar tatimin në pronë (i cili është kusht për të paguar taksën rrugore), pastaj në zyrën Komunale merr fletëpagesën në shumën e caktuar varësishtë prej llojit të automjetit, ku pagesën e kryen në cilëndo bankë.

Subvencionimi i fëmijëve të posalindur

- Formulari i aplikimit.
- Ekstrakti nga regjistri i gjendjes civile për fëmijun.
- Certifikata e vendbanimit të njërit prind.
- Konfirmimi i gjirollogarisë bankare.
- Kopja e letërnjoftimit të njërit prind.
- Vendimi nr. 47/20 të datës 27.02.2020, për ndarjen e mjeteve financiare për fëmijët e posalindur

INFORMACIONE LIDHUR ME TË DRJETAT E QYTETARËVE

E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale

Kushtetuta e garanton të drejtën tuaj për mbrojtje të të dhënave personale. Ajo parasheh që mbledhja, ruajtja dhe përdorimi i të dhënave personale rregullohet me ligj.

Cila është baza ligjore për mbrojtjen e të dhënave tuaja personale?

- Obligimet, përgjegjësitë dhe masat për mbrojtjen e të dhënave tuaja personale janë paraparë në Ligjin nr. 03/L-172, për mbrojtjen e të dhënave personale.

Çka janë të dhënat personale?

- Të dhënat personale janë çdo informacion përmes së cilit mund të identifikohet një person fizik, p.sh. subjekt i të dhënave (emri, numri i letërnjoftimit, adresa e shtëpisë, informata nga dëftesa e pagës etj.).

Çka janë të dhënat personale të ndjeshme?

-Çdo e dhënë personale që zbulon:

- Origjinën racore apo etnike.
- Mendimet politike apo filozofike.
- Besimet fetare.
- Anëtarësia në sindikatë.
- Informacioni për gjendjen shëndetësore.
- Informacioni për jetën seksuale.
- Informacioni për historinë e veprave penale dhe kundërvajtëse.

Tiparet biometrike si p.sh. shenjat e gishtërinjve, shenjat papilare të gishtërinjve, iridës, retinës, karakteristikat e fytyrës dhe ADN-ja, gjithashtu konsiderohen të dhëna personale të ndjeshme. Të dhënat personale të ndjeshme gëzojnë mbrojtje më të madhe p.sh. përpunimi i atyre të dhënave kërkon plotësim të kriterëve më strikte.

Kush është kontrolluesi dhe kush përpunuesi i të dhënave?

Kontrolluesi i të dhënave është personi juridik, nga sektori publik apo privat që e përcakton qëllimin e shfrytëzimit të të dhënave personale.

Përpunues i të dhënave është personi fizik a juridik, nga sektori publik apo privat që i përpunon të dhënat personale, në emër, dhe me udhëzime të kontrolluesit të të dhënave.

Përgjegjësia përfundimtare për përpunim të të dhënave bie mbi kontrolluesin e të dhënave.

Çka është përpunimi i të dhënave?

Përpunimi i të dhënave është çdo veprim që bëhet me të dhënat personale, p.sh. mbledhja, regjistrimi ruajtja, përshtatja, ndryshimi, përdorimi, zbulimi, shpërndarja etj.
Parimet e përpunimit të të dhënave Sipas ligjit, të dhënat personale duhet të përpunohen në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme pa e shkelur dinjitetin e subjekteve të të dhënave.

TË DREJTAT E PËRDORIMIT TË GJUHËVE ZYRTARE

- Gjuha shqipe, gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë dhe kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës.
- Në komunën e Vushtrrisë gjuha turke është gjuhë në përdorim zyrtar, sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin Nr. 02/L-37, për Përdorimin e Gjuhëve.

QASJA NË AKTE KOMUNALE

Pjesëmarrja publike në hartimin e akteve komunale si dhe publikimi i tyre.

Publikimi

Komuna detyrohet të publikoi në mënyrë proaktive çdo dokument publik të prodhuar, të pranuar, të mbajtur apo të kontrolluar, në formë elektronike, përmes publikimit në uebfaqen zyrtare.

Komuna e Vushtrrisë posedon Listën e dokumenteve që i prodhon, mbanë dhe ruan, në të cilën përfshihen:

- Të gjitha dokumentet e përcaktuara sipas nenit 5 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.
- Raportet vjetore dhe periodike.
- Planet dhe Strategjitë.
- Vendime.
- Procesverbalet.
- Marrëveshje të bashkëpunimit.
- Procesi i rekrutimit.
- Katalogu i formularëve.
- Kontaktet.

Përveç publikimit të dokumenteve në uebfaqen zyrtare të Komunës, të gjithë qytetarët kanë të drejtë përmes Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, të kenë qasje në dokumentet e Komunës së Vushtrrisë.

Pjesëmarrja publike në hartimin e akteve komunale

Komuna duhet të siguroi përfshirjen e qytetarëve në konsultime dhe vendimmarrje, duke përdorur por duke mos u kufizuar në mbajtjen e:

1. Takimeve publike
2. Konsultim publik për projekt – aktet normative dhe dokumente të politikave
3. Takime konsultative me qytetarë
4. Dëgjime buxhetore.

Çfarë janë aktet komunale?

Komunat janë të autorizuar të hartojnë dhe miratojnë akte komunale, në bazë të ligjeve bazë dhe në përputhje me to, si dhe të nxjerrin akte që janë të domosdoshme për zbatimin e kompetencave vetanake të komunave.

Aktet komunale përfshijnë:

- Aktet nënligjore komunale të miratuara nga Kuvendi komunal, si dhe
- Vendimet dhe udhëzimet e Kryetarit.

Aktet komunale zbatohen në territorin administrativ të Komunës që i ka nxjerrë, si dhe kryesisht miratohen si vendime dhe rregullore komunale.

Çfarë janë aktet nënligjore të karakterit të përgjithshëm?

Aktet nënligjore komunale të karakterit të përgjithshëm, janë akte që rregullojnë çështje të interesit të përgjithshëm. Përshembull: nëse Komuna juaj planifikon të ndërtojë një hapësirë parkimi apo të ngrejë një statujë në sheshin publik, këto akte janë të interesit të përgjithshëm publik. Disa shembuj të akteve komunale të karakterit të përgjithshëm:

- Plani rregullues urban komunal.
- Plani komunal i menaxhimit të mbeturinave.
- Rregullorja komunale për taksat, tarifat dhe gjobat.
- Rregullorja komunale për përdorimin e gjuhëve.
- Rregullorja komunale për bashkëpunim me fshatrat dhe lagjet urbane.
- Rregullorja komunale për regjistrimin e bizneseve.
- Rregullorja komunale për licencimin e shoqërive tregtare.
- Rregullorja komunale për bursat e studentëve.
- Rregullorja komunale për ndarjen e banimit social.
- Rregullorja komunale për shërbimet e taksive.
- Rregullorja komunale për tatimin në pronë etj.

Me ligj, Komuna obligohet të konsultoi publikun, në hartimin e akteve komunale. Konsultimi i publikut dhe grupeve të interesit për projekt-akte komunale është pjesë e procesit legjislativ të paraparë me ligj.

QYTETARËT KANË TË DREJTËN E QASJES NË PROJEKT-AKTE NËNLIGJORE KOMUNALE, NË FAZËN E HARTIMIT PARA SE TË MIRATOHEN NGA KUVENDI KOMUNAL.

- JU KENI TË DREJTË TË QASJES NË PROJEKT-AKTE NËNLIGJORE KOMUNALE, NË FAZËN E HARTIMIT PARA SE TË MIRATOHEN NGA KUVENDI KOMUNAL.

Si konsultohet publiku mbi projekt-aktet komunale?

Mënyra më e shpeshtë e konsultimit publik për projekt-aktet komunale është përmes takimeve publike. Këto takime duhen organizuar në mënyrën që nxitë pjesëmarrjen më të madhe publike. Gjegjësisht, Komuna është e obliguar t'i informoj për:

- Datën.
- Vendin.
- Orën.
- Rendin e ditës.
- Qëllimin.

Njoftimi duhet të bëhet dy javë para takimit, me anë të:

- Tabelave të njoftimit public, në vendet më të frekuentuara të qytetit dhe/ose fshatit.
- Hapësirat e objektit të Komunës.
- Mediat elektronike dhe shtypi.
- Faqes/ve zyrtare të internetit të Komunës.

Ligji vë theks të posaçëm te zonat rurale për organizimin e debateve publike mbi projekt-aktet komunale të interesit publik.

Të gjitha propozimet për projekt-aktet komunale, të parashtruara nga banorët dhe grupet e interesit në takime publike, duhen shqyrtuar brenda 15 ditësh, nga data kur parashtrohen, si dhe t'i prezantohen Kuvendit Komunal.

Publikimi i akteve komunale, Komunitat janë të obliguara të publikojnë dhe të mundësojnë qasjen në të gjitha aktet komunale, me përjashtime sipas përcaktimit të ligjit. Këto akte duhet të jenë të qasshme në mënyrë efikase, kryesisht duke i vendosur ato në faqet zyrtare të internetit.

Qytetarët mund t'i qasen akteve komunale edhe me anë të ushtrimit të të drejtës për qasje në dokumente publike.

**TË GJITHA AKTET KOMUNALE DUHET TË JENË TË QASSHME NË GJUHËT
ZYRTARE DHE GJUHËT NË PËRDORIM ZYRTAR NË KOMUNËN TUAJ**

Publikimi i akteve nënligjore komunale parashihet me rregulloren për hartimin dhe publikimin e akteve komunale. Me publikimin e tyre, plotësohet cikli i plotë i procesit ligjvënës komunal.

Kur hyjnë në fuqi aktet nënligjore komunale?

Aktet nënligjore komunale hyjnë në fuqi pas publikimit të tyre, si dhe nga data e paraparë në vetë aktin nënligjor komunal. Në raste përjashtuese, këto akte mund të kenë efekt prapaveprues, gjë që gjithashtu parashihet në vetë aktin nënligjor komunal.

**AKTET NËNLIGJORE KOMUNALE HYJNË NË FUQI 15 DITË NGA PUBLIKIMI I TYRE
NË FAQEN ZYRTARE TË KOMUNËS**

Publikimi i akteve nënligjore komunale në faqen zyrtare të internetit të Komunës, në gjuhët zyrtare të Komunës, është detyrim ligjor. Përveç kësaj, ato duhen publikuar edhe në kopje fizike/të shtypur. Të gjitha aktet nënligjore komunale publikohen në një vegëz të posaçme e cila mund të gjendet në faqen zyrtare të Komunës, si në shembullin e mëposhtëm:

<https://vushttri.rks-gov.net>

Ky dokument do të plotësohet e ndryshohet, varësisht nga kërkesat që mund të vijnë nga drejtorët e drejtorive komunale dhe kërkesës së kryetarit të Komunës.

Hyrja në fuqi

Ky udhëzues hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Kryetari i Komunës
Ferit Idrizi

